

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6282
E hënë, 5 prill 2021
çmimi 0.40 €

Limaj: Demokracia në rrezik, Kosova po qeveriset nga partia shtet **FAQE 3**



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KUVENDI I KOSOVËS KA MBAJTUR SEANCË TË JASHTËZAKONSHME PËR ZGJEDHJEN E PRESIDENTIT **FAQE 4-5**

VJOSA OSMANI SADRIU ZGJIDHET PRESIDENTE



Me 71 vota për deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë zgjedhur të dielën Vjosa Osmani Sadriu presidente e Republikës së Kosovës. Ajo ka fituar në raundin e tretë të votimit. Për kundërkandidat kishte ish-kandidatin për deputet Nasuf

Bejtën. Në raundin e tretë të votimit morën pjesë 82 deputetë. 11 vota ishin të pavlefshme. Në votimin e presidentit nuk kanë marrë pjesë deputetët e PDK-së, të AAK-së dhe të Listës Serbe, ndërkaq deputetët e LDK-së ia kanë

bërë kuorumin Osmani Sadriu për t'u zgjedhur presidente. Deputetët Adem Hoxha, Fadil Gashi, Adelina Grainca dhe Albena Reshitaj kanë qenë vendimtarë për zgjedhjen e Vjosa Osmani Sadriu presidente e Kosovës

PARALAJMËROHET MBYLLJE E RE, KOMUNAT DHE GASTRONOMËT KUNDËRSHTOJNË **FAQE 3**



Ministria e Shëndetësisë (MSH) ka paralajmëruar masa të reja kundër Covidit të cilat pritet ta mbyllin vendin nga 6 deri më 18 prill. Këto masa janë kundërshtuar nga disa komuna dhe nga gastronomët. Sipas

tyre, mbyllja e sërishe e vendit është vendim arbitrar. Me masat e reja pritet mbyllja e gastronomisë, qendrave tregtare, GYM-ave dhe shkollave, ndërsa institucionet duhet të punojnë me staf esencial

FESTOHEN PASHKËT NË KOSOVË, PËRCILLEN MESAZHE SHPRESE PËR DITË MË TË MIRA NË KËTË KOHË PANDEMIE **FAQE 6**



AKTUALE



NË MITROVICË SHËNOHET 40-VJETORI I DEMONSTRATAVE TË VITIT 1981 **F. 8**

EMËROHEN ZËVENDËSMINISTRAT NË TETË MINISTRI **F. 7**

RRITET NDJESHËM NUMRI I RASTEVE TË REJA ME COVID-19 NË JAPONI **F. 2**



EKONOMI

SHKUARJA E VENDIT NË ZGJEDHJE, E RREZIKSHME PËR EKONOMINË **F. 9**

AVUK-U REALIZOI 80 INSPEKTIVE NË PRIZREN, SHOIPTOI GJOBA DHE MBYLLI DISA LOKALE **F. 9**



SPORT

PRISHTINA MERR TRI PIKË NË SUHAREKË, 'NIKLI' DEKLASON LLAPIN **F. 12**

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Pruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Britani, protesta kundër dhunës ndaj grave

LONDËR, 4 PRILL - Pavarësisht prej kufizimeve për shkak të pandemisë së koronavirusit, në Londër u organizuan protesta kundër

dhunës ndaj grave. Rreth 200 protestues, kryesisht gra, u mbledhën në sheshin "Trafalgar" dhe kërkuan ndëshkime më të rrepta nga

autoritetet për dhunën ndaj grave. U organizua një marsh protestues ku pjesëmarrësit mbanin pankarta me mbishkrime të

ndryshme. Megjithëse në Britani është ndaluar tubimi i më shumë se 6 personave, policia nuk ndërhyri ndaj protestuesve.



Blinken: Izraelitët dhe palestinezët duhet të kenë liri të barabarta

UASHINGTON, 4 PRILL - Sekretari i Shtetit të ShBA-së, Antony Blinken, në një bisedë telefonike me homologun izraelit Gabi Ashkenazi, ka pohuar se izraelitët dhe palestinezët duhet të kenë liri, siguri, mirëqenie dhe demokraci të barabarta. Zëdhënësi i Departamentit Amerikan i Shtetit, Ned Price, dha një deklaratë me shkrim lidhur me bisedën telefonike të zhvilluar mes Blinken dhe

Ashkenazi. Sipas deklaratës, dy ministrat, krahas marrëdhënieve dypalëshe dhe çështjeve rajonale, biseduan edhe për ndihmat humanitare të ShBA-së për Palestinën si dhe proceset e normalizimit mes Izraelit me disa vende arabe dhe myslimane. "Sekretari nënvizoi besimin e administratës së Bidenit në drejtimin se izraelitët dhe palestinezët duhet të kenë liri, siguri, mirëqenie dhe

demokraci të barabarta", thuhet në deklaratën në të cilën më tej vihet në dukje se ShBA-ja ka shprehur sërish angazhimin e saj në mënyrën më të fuqishme lidhur me sigurinë e Izraelit. Administrata e Joe Bidenit në ShBA aktivizoi sërish ndihmat për Palestinën të pezulluara në periudhën e Donald Trumpit dhe deklaroi se do të tregonte përpjekje për zgjidhjen me dy shtete.



Rusia e vazhdon bashkëpunimin hapësinor me ShBA-në

MOSKË, 4 PRILL - Rusia ka vendosur që ta zgjasë bashkëpunimin hapësinor me Shtetet e Bashkuara deri në vitin 2030. Kryeministri rus, Mikhail Mishustin, miratoi dhe nënshkroi paktin, tha qeveria në një deklaratë. Marrëveshja është nënshkruar në vitin 1992 dhe deri më tani është zgjatuar katër herë. Pakti vendosi bazat për bashkëpunim mes dy vendeve në projekte të mëdha në hapësirë përfshirë hulumtimet në mes të



Agjencisë Hapësinore të ShBA-së (NASA) dhe asaj ruse Roskosmos. Të dyja vendet kanë punuar bashkë në kuadër të Stacionit Ndërkombëtar të Hapësirës,

transportimin e astronautëve dhe furnizimeve. Pas vendimit të ShBA-së për ta ndaluar flotën e saj të anijeve kozmike, anijet kozmike ruse Soyuz dhe Progress u bënë mjete i vetëm i transportit për të arritur në stacion. Por, kjo praktikë ka ndryshuar kohët e fundit pasi ndërmarjet private të hapësirës, përfshirë SpaceX, janë afër marrjes së miratimit të NASA-s për të dërguar njerëz në Stacionin Hapësinor. Ky veprim do të privojë Roskosmos nga të

ardhurat shumë të nevojshme. Bashkëpunimi dypalësh ka vazhduar edhe pasi Shtetet e Bashkuara vendosën sanksione ndaj Rusisë për aneksimin e Krimesë në Ukrainë dhe masave të tjera ndëshkuese. Muajin e kaluar Departamenti i Tregtisë i ShBA-së ka njoftuar se po ashpëronte sanksionet për disa eksporte në Rusi, por ka përjashtuar pjesërisht artikuj të caktuar siç janë ato që lidhen me aviacionin dhe hapësirën.

Sulm pranë bazës ajrore me ushtarë amerikanë në Irak

BAGDAD, 4 PRILL - Dy raketa goditën të dielën një vend pranë një baze ajrore irakiane që strehon ushtarë amerikanë në veri të Bagdadit. Askush nuk e ka marrë ende përgjegjësinë për sulmin, por ShBA-ja rregullisht fajëson fraksionet irakiane të lidhura me Iranin për sulme të tilla ndaj trupave dhe diplomatëve të saj. Grupet paraushtarake

të lidhura me Iranin kanë kërkuar që të gjitha trupat e huaja, duke përfshirë forcat amerikane, të largohen nga Iraku, duke e quajtur praninë e tyre një okupim. ShBA-ja mban rreth 2 500 trupa në Irak. Misioni i një koalicioni të udhëhequr nga ShBA-ja në Irak është lufta kundër militantëve të grupit të ashtuquajtur Shtetit Islamik.

Në këtë vend është, gjithashtu, një mision i udhëhequr nga NATO-ja që trajnon forcat irakiane të sigurisë. Sulmi i fundit ndodhi derisa Uashingtoni po përgatitet të nisë një dialog strategjik me qeverinë e kryeministrit irakian Mustafa al-Kadhemi, i cili ka marrë rregullisht kërcënime nga fraksionet pro-Iranit.



Rritet ndjeshëm numri i rasteve të reja me Covid-19 në Japoni

TOKIO, 4 PRILL - Rastet e infektimit me Covid-19 vazhdojnë të shënojnë një rritje të ndjeshme në Japoni, veçanërisht në Osaka, ku për të pestën

ditë radhazi është tejkalar shkalla e pozitivitetit të Tokios. Metropoli i dytë i arkipelagut ka përditësuar të dielën rekordin e rasteve me 666 infektimit të reja

me Covid në 24 orët e fundit. Në Tokio u regjistruan 442 infeksione ditore, duke bërë që gjendja e gatishmërisë të vendoset

në nivelin e tretë në një shkallë maksimale prej 4, së bashku me prefekturën Hyogo, e tejkalar vetëm nga Osaka dhe prefektura në veriperëndim e Miyagit.



KUVENDI I KOSOVËS KA MBAJTUR SEANCË TË JASHTËZAKONSHME PËR ZGJEDHJEN E PRESIDENTIT

Vjosa Osmani Sadriu zgjidhet presidente

Me 71 vota për deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë zgjedhur të dielën Vjosa Osmani Sadriu presidente e Republikës së Kosovës. Ajo ka fituar në raundin e tretë të votimit. Për kundërkandidat kishte ish-kandidatin për deputet Nasuf Bejtën. Në raundin e tretë të votimit morën pjesë 82 deputetë. 11 vota ishin të pavlefshme. Në votimin e presidentit nuk kanë marrë pjesë deputetët e PDK-së, të AAK-së dhe të Listës Serbe, ndërkaq deputetët e LDK-së ia kanë bërë kuorumin Osmani Sadriut për t'u zgjedhur presidente. Deputetët Adem Hoxha, Fadil Gashi, Adelina Grainca dhe Albena Reshitaj kanë qenë vendimtarë për zgjedhjen e Vjosa Osmani Sadriu presidente e Kosovës



**EPOKA
ERE** **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 4 PRILL- Kandidatja e Lëvizjes Vetëvendosje nga Lista "Guxo", Vjosa Osmani Sadriu, është zgjedhur presidente e Kosovës. Osmani Sadriu u zgjodh presidente në raundin tretë, i cili ishte final për përcaktimin e presidentit të ri të vendit. Në votim kanë marrë pjesë 82 deputetë, ndërsa Osmani Sadriu ka marrë 71 vota për dhe 11 të pavlefshme, të nevojshme për kreun e shtetit. Deputetët e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) ia kanë bërë kuorumin Osmani Sadriut për t'u zgjedhur në postin e presidentit. Dymbëdhjetë deputetë të LDK-së kanë marrë pjesë në votim, duke përfshirë tre deputetët: Agim Veliu, Avdullah Hoti dhe Driton Selmanaj të cilët nuk kanë marrë pjesë në votim. Deputetët Adem Hoxha, Fadil Gashi, Adelina Grainca (PDK) e cila tashmë ka kaluar në grupin parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje dhe Albena Reshitaj (AAK) kanë qenë vendimtarë në zgjedhjen e Vjosa Osmanit presidente e Kosovës. Votimi i zgjedhjes së presidentit është bojkotuar nga Partia Demokratike e Kosovës, përjashto këtu deputeten Adelina Grainca, Listën Serbe,

ndërsa nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës ka marrë pjesë vetëm deputetja Albena Reshitaj.

Të shtunën, për shkak të mungesës së kuorunit në votim, Kuvendi i Kosovës nuk ka arritur ta zgjedhë presidentin e vendit. Gjatë së shtunës raundi i parë i votimit u përsërit dy herë, pasi në votim nuk morën pjesë 80 deputetë apo dy e treta e deputetëve, numër ky i nevojshëm për t'u konsideruar i konsumuar raundi i parë i votimit.

Në këto dy votime morën pjesë 78, përkatësisht 79 deputetë.

Pas zgjedhjes në krye të kësaj pozite dhe pasi bëri betimin para deputetëve, Vjosa Osmani Sadriu ka mbajtur fjalim. Në adresimin e saj në Kuvendit, Osmani Sadriu ka thënë se ky post e mvsh atë me përgjegjësi të madhe. "Sot është dita kur vullneti juaj (i qytetarëve) i shprehur me 14 shkurt po jetësohet", ka thënë ajo. Mandati i presidentit është pesë vjet. Pas përfundimit të mandatit të parë, presidenti mund të rizgjidhet vetëm edhe një herë. Pas zgjedhjes presidenti nuk mund të ushtrojë asnjë funksion në parti politike.

Osmani-Sadriu, e cila kishte drejtuar Kuvendin e Kosovës një vit, nga 3 shkurti 2020 deri më 22 mars 2021, tani do të mbajë një nga postet më të larta shtetërore,

atë të presidentes së Republikës së Kosovës. Që prej 5 nëntorit 2020 Kosova është me ushtrues detyre të presidentit, pasi Hashim Thaçi ka dhënë dorëheqje nga kjo pozitë, pas konfirmimit të aktakuzës për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit nga Dhomat e Specializuara në Hagë. Dikur aktiviste e Lidhjes Demokratike e Kosovës, më pas Osmani Sadriu arriti të bëhej edhe nënkryetare e kësaj partie. Si deputete nga LDK-ja në Kuvendin e Kosovës në katër legjislatura, Vjosa Osmani ka qenë kryetare e komisionit për punë të jashtme, diasporë dhe investime strategjike dhe kryetare e komisionit për integritet evropiane. Osmani Sadriu në zgjedhjet e 14 shkurtit ishte politikania më e votuar, përkatësisht ajo fitoi mbi 300 mijë vota.

PROFILI I VJOSA OSMANIT

Dr. Vjosa Osmani Sadriu lindi më 17 maj 1982 në Mitrovicë (Kosovë). Shkollimin fillor dhe të mesëm i ka mbaruar në Mitrovicë, ndërkaq Fakultetin e Drejtësisë e ka mbaruar në Universitetin e Prishtinës. Studimet master dhe studimet e doktoraturës i ka mbaruar në Universitetin e Pittsburgut në Pensilvani, ShBA. Është zgjedhur deputete në Kuvendin e Republikës së Kosovës në katër mandate, duke u bërë kështu gruaja më e votuar në histori të zgjedhjeve parlamentare në Kosovë si dhe politikania e dytë më e votuar në zgjedhje parlamentare. Në mandatet e kaluara ajo ka udhëhequr komisionin parlamentar për punë të jashtme, komisionin për integritet evropiane dhe ka qenë nënkryetare e komisionit për reformë kushtetuese. Më 3 shkurt 2020 Vjosa Osmani Sadriu u zgjodh kryetarja e parë grua e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Më 5 nëntor 2020 mori detyrën e u. d. si presidente e Republikës së Kosovës. Gjatë viteve 2006-2010 Vjosa Osmani Sadriu ka shërbyer shefe e stafit e presidentit Sejdiu dhe këshilltare e lartë për çështje ligjore dhe marrëdhënie ndërkombëtare.


Ajo ka përfaqësuar presidentin në komisionin për hartimin e Kushtetutës të Republikës së Kosovës. Ka qenë anëtare e ekipit përfaqësues e Republikës së Kosovës në rastin para Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë lidhur me shpalljen e pavarësisë së Kosovës. Që nga viti 2006 ka ligjruar në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës, ndërsa si profesor vizitor ka ligjruar edhe në Universitetin e Pittsburgut në ShBA. Për disa vite ka ligjruar edhe në RIT - Kosovo (AUK), Kolegjin AAB - Riinvest si dhe ka mbajtur ligjërata tematike në universitete të tjera në Evropë e në ShBA. Nga Universiteti i Pittsburgut është nderuar me çmimin "Sheth International Award". Është anëtare e Bordit të Rrjetit Parlamentar të Bankës Botërore dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe anëtare në Komisionin Drejtues të Deputetëve të rinj të Bankës Botërore dhe FMN-së. Flet gjuhën angleze, turke, serbokroate dhe komunikon në spanjisht. Është e martuar dhe ka dy vajza binjake. Jeton në Prishtinë.

PDK-ja: Grainca e shiti votën për ta votuar Osmanin për presidente

Partia Demokratike e Kosovës (PDK) përmes një reagimi për media të dielën ka theksuar se Adelina Grainca e ka shitur votën për ta votuar Vjosa Osmanin për presidente. "Partia Demokratike e Kosovës ka shkarkuar sot nga

të gjitha funksionet deputeten Adelina Grainca, pasi ajo tradhtoi votën e elektoratit të PDK-së dhe e shiti votën e saj për ta votuar Vjosa Osmanin për presidente. PDK-ja ka qenë e njoftuar qysh më herët se Albin Kurti ka hyrë në

pazare me deputeten dhe familjarët e saj duke i ofruar para të majme, privilegje dhe qasje në tenderë publikë për bizneset që ka deputetja Grainca dhe familja e saj", është thënë në reagimin e PDK-së.



MINISTRA E SHËNDETËSISË (MSH) KA PARALAJMËRUAR MASA TË REJA KUNDËR COVIDIT NGA DITA E MARTË

Paralajmërohet mbyllje, komunat dhe gastronomët kundërshtojnë

Ministria e Shëndetësisë (MSh) ka paralajmëruar masa të reja kundër Covidit të cilat pritet ta mbyllin vendin nga 6 deri më 18 prill. Këto masa janë kundërshtuar nga disa komuna dhe nga gastronomët. Sipas tyre, mbyllja e sërishme e vendit është vendim arbitrar. Me masat e reja pritet mbyllja e gastronomisë, e qendrave tregtare, e GYM-ave dhe e shkollave, ndërsa institucionet duhet të punojnë me staf esencial

**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 4 PRILL - Rritja e numrit të infektiveve me Covid-19 dhe ngarkesa e spitaleve me pacientë që po kërkojnë trajtim, ka nxitur institucionet të mendojnë për masa të reja kundër Covidit. Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, ka paralajmëruar kufizim të masave të cilat parashohin një izolim të ri të vendit. Masat e reja kufizuese, sipas burimeve brenda MSh-së, pritet ta mbyllin vendin për dy

javë.

Mbyllja, që pritet të fillojë nga 6 deri më 18 prill, përfshinë mbylljen e gastronomisë, qendrave tregtare, GYM-ave dhe shkollave, ndërsa institucionet duhet të punojnë me staf esencial.

Për këtë qëllim, ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, së bashku me ministrin e Administrimit të Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi, kanë mbajtur të dielën një takim virtual koordinues me kryetarët e komunave. Ministri Vitia iu ka thënë

kryetarëve të komunave se vendi ndodhet në një situatë të rënduar. Ai ka theksuar se duhet mobilizim, koordinim dhe qasje më proaktive në raport me pandeminë për shkak të situatës së krijuar. Gjithashtu, Vitia ka diskutuar së bashku me kryetarët e komunave nevojën e disa masave të reja të cilat, në bashkëpunim me të gjitha institucionet relevante, duhet të ndërmerren për ta ruajtur shëndetin publik. "Kryetarët e komunave diskutuan rreth sfidave të ndryshme me të cilat

janë duke u ballafaquar dhe dhanë mendimet dhe sugjerimet e tyre për vendimet që duhen të merren nga institucionet përkatëse. Si përfundim të pranishmit u pajtuan që bashkërisht, duke i koordinuar të gjitha veprimet rreth masave të reja, mund t'ia dalin për t'i zvogëluar dhe tejkaluar sfidat me të cilat janë duke u përballur me pandeminë Covid-19", është thënë në njoftimin e MAPL-së.

Komunat dhe gastronomët kundërshtojnë masat e reja

Bordi i Asociacionit i Komunave të Kosovës (AKK) ka bërë me dije se kundërshton masat e reja kufizuese që i ka paralajmëruar qeveria. Në këtë takim që ka mbajtur AKK-ja ka

vlerësuar se është shumë e rëndësishme që masat aktuale kundër përhapjes së pandemisë Covid-19 të vazhdojnë të zbatohen në mbrojtje të shëndetit të qytetarëve. "Bordi në anën tjetër vlerëson se nuk i përkrah masat e reja që sjellin kufizime më të ashpra. Ky vlerësim vjen për arsye se, pavarësisht prej qëllimeve të mira shëndetësore, kjo mbyllje do të ndikojë tepër rëndë në sektorë të caktuar të ekonomisë së vendit tonë. Kryetarët e komunave vlerësojnë se duhet të respektohen masat aktuale me rigorozitet, të rritet numri i aktiviteteve inspektuese, të rritet angazhimi dhe përkushtimi i policisë, të rritet edhe përkrahja me barna esenciale sepse ka ngecje serioze me furnizim. Nuk është




mirë të ketë kufizime sepse është koha e të mbjellave. Edhe gastronomia është e lidhur me bujqësinë”, është thënë në njoftimin e AKK-së.

Kurse nënkryetari i Komunës së Gjilanit, Arbër Ismajli, ka thënë se në takimin virtual që kanë pasur me ministrin e Shëndetësisë, ka kundërshtuar kategorikisht mbylljen totale si pasojë e pandemisë Covid-19. “Si komunë, jemi kategorikisht kundër mbylljes totale. Kjo

përkrahje na erdhi edhe nga shumë komuna të tjera. Të mendosh për mbyllje totale është t’ia shkaktosh vetes një greminë të thellë nga e cila edhe ashtu kemi çaluar”, ka thënë Ismajli.

Paralajmërimet për masat e reja i ka kundërshtuar edhe Oda e Afarizmit e Kosovës. Kjo ka kërkuar nga institucionet e Kosovës që asnjë kufizim apo mbyllje totale e bizneseve të mos bëhet pa përkrahje

paraprake financiare. “Oda e Afarizmit konsideron se sektori privat aktualisht është shumë i rënduar si rezultat i pandemisë, andaj nuk ka kapacitete që t’i përballojë i vetëm pasojat e mëtutjeshme shkaktuar nga pandemia, ku si rezultat i mospërkrahjes financiare bizneset e kanë të pamundur që të mbajnë në punë numrin e të punësuarve që kanë pasur deri më tani”, është thënë në reagimin e



Nëntë viktima dhe 680 raste me Covid në 24 orët e fundit

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në IKShPK dhe laboratorët privatë me metodën RT-PCR si dhe në laboratorët publikë dhe privatë me metodën RAT janë testuar gjithsej 4 086 mostra të marra nga ShSKUK dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 680 raste pozitive. Brenda 24 orëve janë raportuar 9 raste të të vdekurve me SARS CoV-2 pozitiv. Rastet e të vdekurve janë nga komunat: Prishtinë 3 raste (69, 67, 53 vjeç), Gjakovë 2 raste (80, 79 vjeç), Deçan 1 rast (78 vjeç),

Malishevë 1 rast (74 vjeç), Podujevë 1 rast (66 vjeç) dhe Viti 1 rast (65 vjeç)”, është në njoftimin e institutit, duke treguar numrin e infektiveve nëpër komuna. “Rastet pozitive janë nga komunat: Prishtinë 177 raste, Gjilan 58 raste, Ferizaj 51 raste, Gjakovë 51 raste, Mitrovicë 46 raste, Pejë 39 raste, Podujevë 32 raste, Vushtrri 28 raste, Fushë Kosovë 21 raste, Kamenicë 20 raste, Viti 19 raste, Prizren 17 raste, Istog 14 raste, Klinë 14 raste, Lipjan 14 raste, Shtime 13 raste, Suharekë 10 raste, Hani i Elezit 8 raste, Deçan 7 raste, Malishevë 7 raste, Skenderaj 7 raste, Drenas 6 raste, Dragash 5 raste, Obiliq 5 raste, Rahovec 3 raste, Junik 2 raste, Kaçanik 2 raste, Shtërpçë 2 raste dhe me nga një rast komunat Novobërdë dhe Zubin-Potok”, ka treguar instituti. Numri total i rasteve pozitive është 93 655 raste nga 443 122 persona të dyshimtë me virusin SARS-CoV-2 dhe 1 915 raste të të vdekurve.

OAK-së.

Kurse kryetari i Gastronomëve të Kosovës, Petrit Kllloqi, masat e reja i ka vlerësuar arbitrare. “Pavarësisht prej faktit që ne ishim të ftuar për konsultim, ne nuk u konsultuam, por u informuam për vendimin e mbylljes së gastronomisë, qendrave tregtare, GYM-ave dhe shkollave, nga data 06 deri më 18 të këtij muaji. Ky vendim është arbitrar, i njëanshëm, dhe jo i pranueshëm për gastronominë e Kosovës e cila çdo ditë e më shumë po rrezohet për tokë. Ne

kundërshtojmë fuqishëm këtë vendim dhe do të vazhdojmë ta kundërshtojmë edhe më tutje çdo vendim që merret njëanshëm pa konsultim”, ka shkruar ai në profilin e vet në “Facebook”, duke treguar se të hënën në orën 14:00 do të mbahet Kuvendi i Shoqatës i Gastronomëve të Kosovës ku do të diskutohet për këto masa. Numri i rasteve të reja me Covid-19 ka shënuar rritje në javët e fundit në Kosovë.


Autoritetet shëndetësore që nga fillimi i rritjes së numrit të rasteve kanë theksuar se ka mbingarkesë të kapaciteteve

Kurti pranon urime nga presidenti i Zvicrës: Falë diasporës, vendet tona janë fort të lidhura

PRISHTINË, 4 PRILL (ER)-Presidenti i Konfederatës Zvicerane, Guy Parmelin, në emër të Këshillit Federal të Konfederatës Zvicerane, ka uruar kryeministrin e Republikës së Kosovës, Albin Kurti, për detyrën e kreut të ekzekutivit. Marrëdhëniet shumë të mira dhe miqësore ndërmjet Zvicrës dhe

Kosovës janë të bazuara në besim të ndërsjellë, ka shkruar presidenti Parmelin. Ai ka thënë se falë diasporës së rëndësishme kosovare në Zvicër, dy vendet janë të lidhura fort edhe në aspektin njerëzor dhe kulturor. “Prosperiteti i Ballkanit Perëndimor është interes i yni i përbashkët, prandaj

edhe vendi im ka qenë për shumë vite shumë i angazhuar në një gamë të gjerë të programeve të bashkëpunimit me qëllim zhvillimin dhe mbështetjen e paqes”, ka vazhduar letra e tij. Në fund, presidenti i Zvicrës ka shkruar se pret që bashkëpunimi i mirë mes dy vendeve të vazhdojë.



Festohen pashkët në Kosovë, përcillen mesazhe shprese për ditë më të mira në këtë kohë pandemie

PRISHTINË, 4 PRILL (ER) - Të dielën është mbajtur mesha e pashkëve në Katedralen e "Shën Nënë Tereza" në Prishtinë.

Mesha është mbajtur nën drejtimin e Don Lush Gjergji nga Ipeshkvia e Kosovës.

Don Lush Gjergji në kremtimin e ditës së pashkëve ka dërguar mesazhe dhe urime për të gjithë besimtarët krishterë.

Sikurse viti i kaluar edhe këtë vit pashkët kremtohen në kohën kur e gjithë bota po përballet me pandeminë Covid-19. Për çka ai është shprehur se në këtë kohë të zymtë dhe të pandemisë dhe ngjarjeve që po ndodhin te ne dhe në botë duhet të kemi sigurinë dhe ta ngjallim shpresën dhe dashurinë.

Don Lush Gjergji ka thënë se përmes veprimeve të mira njerëzit mund ta gjejnë Zotin.

"Në këtë kohë të zymtë dhe të pandemisë dhe ngjarjeve të ndryshme që ndodhen te ne dhe në botë, ta kemi sigurinë, ngjalljen e shpresës dhe ndezjen e dashurisë. Të përfjethë siç përfjethet tjetri, të përfjethë se varri është i zbrazët se nuk jemi të krijuar për varr, për shkatërrim për vdekje dhe për asgjësim, por për jetë. Dhe mirëkuptimi i kësaj jetë është parathënia e jetës së pasosur të cilën e arrijmë me Krishtin e ngjallur. Me këto ndjenja të thella, me nderim dhe dashurinë e ndaj Krishtit, juve dhe gjithë të tjerëve ju dëshirojmë pashkët e shenja, pashkët e bardha, pashkët e bekuara, pashkët të cilat prekin thelbin e jetës sonë, ndërrojnë, përmirësojnë dhe shenjtërojnë jetën tonë", ka thënë Don Lush Gjergji.

Ndërkaq në mbrëmjen e së shtunës në Katedralen "Shën Nënë Tereza" në Prishtinë, nën



drejtimin e Ipeshkvisë së Kosovës, Izmot Dodë Gjergji, është mbajtur ceremonia e Meshës Solemne të Pashkëve. Ai ka thënë se pashkët e sivjetme po i kremtojmë nën dritëhijën e shpresës ngushëlluese që po vjen nëpërmjet vaksinimit të njerëzve. "Fort të dashur vëllezër e motra, që nga pashkët e vitit të kaluar, bota është përballur me shumë se herëve të tjera me vdekjen, edhe pse të gjithë do të donim të mos mendonim për të. Po ja që rrallëkush ka mbetur pa e përjetuar paksa trishtimin që vdekja mbartë me vete, zemërtjerjen që shkakton ajo dhe lotin që nxjerr dhimbja e saj, pasi kemi humbur të dashurit ose kemi bashkëndarë dhimbjen me ata që kanë humbur të afërmit e tyre. Kohët e fundit, ndonëse pandemia Covid-19 akoma po merr jetë njerëzish, kemi filluar të

shpresojmë më shumë për mundësitë që po jep vakcina. Kështu që, nëse pashkët e vitit të kaluar i kemi kremtuar nën hijen e frikës njerëzore, pashkët e sivjetme po i kremtojmë nën dritëhijën e shpresës ngushëlluese që po vjen nëpërmjet vaksinimit të njerëzve", ka thënë në mesazhin e tij Izmot Dodë Gjergji.

Ai ka theksuar se: "Ne të krishterët, që në Treditëshin e Shenjtë të Pashkëve, thellohemi në përsiatjen e padrejtësive që i shkakton bota, në vdekjen e padrejtë të Krishtit dhe në ngadhënjimin e Ringjalljes së Tij. Besojmë se me forcën e të Kryqëzuarit arrijmë të përballojmë më lehtë çdo të keqe me të cilën sfidohehi. Sepse, shembulli i Krishtit që vuan, na mëson si të përballemi me vuajtjen tonë me dashuri, e cila na nxitë në përpjekje të përbashkëta për t'i tejkuluar vështirësitë, për t'u përballë me

padrejtësitë dhe për ta ngushëlluar njëri-tjetrin. Mbi të gjitha, pjesëmarrja në gëzimin e Ringjalljes na mundëson që vdekjen ta shohim nga dimensionin i pavdekësisë hyjnore. Duke shpresuar dhe duke besuar se, ne, të vdekshmit, që jemi gjallë mbi tokë, nëpërmjet ngjalljes së Krishtit, të gjithë jemi të ftuar në pavdekësi dhe në jetën e pasosur", ka deklaruar Dodë Gjergji.

Me rastin e kremtimit të ditës së pashkëve, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka uruar gjithë besimtarët katolikë e protestantë. Në profilin e vet në "Facebook", ai ka shkruar se pashkët janë simbol i sakrificimit, i shpresës dhe i fillimeve të reja. "Urime pashkët për të gjithë besimtarët katolikë e protestantë! Kjo fundjavë është e veçantë për besimtarët katolikë e protestantë në Kosovë dhe në mbarë botën.

Janë këto ditët e afrimit me njëri-tjetrin, por edhe të besimit mes nesh. Si festë e ringjalljes dhe ripërtëritjes, pashkët janë simbol i sakrificimit dhe i shpresës, i fillimeve të reja. Si shoqëri dhe si shtet po kalojmë kohë të vështira si pasojë e pandemisë Covid-19, por edhe e problemeve të grumbulluara me dekada sfida që, përveç aftësisë, shpeshherë testojnë edhe durimin tonë. Por, ky fillimvit na ka dëshmuar sërish se kur bëhemi bashkë tejkalojmë çdo pengesë, sado e madhe të jetë", ka shkruar Kurti në urimin e tij.

Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku, ka uruar të gjithë besimtarët katolikë me rastin e festës së pashkëve. "Këto pashkët na gjejnë të gjithëve duke u përballur me pandeminë. Shpresa për një ditë të mirë do të na mbajë gjallë gjithmonë. Le të jetë kjo ditë e ringjalljes së besimit që shpejt do të jemi bashkë në çdo kremte duke ia shtrirë dorën njëri-tjetrit për ta uruar. Gëzuar për shumë mot pashkët!", thuhet në urimin e Abdixhikut.

Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka uruar Ipeshkvin e Kosovës, Izmot Dodë Gjergji, shqiptarët katolikë dhe miqtë ndërkombëtarë për gëzuar dhe për pashkët. "Pashkët na kujtojnë sakrificën dhe triumfin e jetës mbi vdekjen, vlera me të cilat shqiptarët u mishëruan gjatë historisë", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Për shkak të gjendjes së pandemisë Covid-19 që po mbretëron ende në vendin tonë, të gjitha aktivitetet e tjera për këtë festë janë anuluar, përfshirë edhe pritjen solemne të festës.



Limaj: Demokracia në rrezik, Kosova po qeveriset nga partia shtet

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

MALISHEVË, 4 PRILL - Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka thënë se Kosova është futur në një rrugë më shumë të panjohura. Ai ka thënë se sot Kosova është duke u qeverisur nga partia shtet. Kjo, sipas tij, nuk ka ndodhur asnjëherë që vendi të qeveriset nga parti e vetme. "Shpejt do ta shihni, është si shkumë sapuni. Do ta shihni këtë kohë se sa

shpejt kjo që sot është modë do t'i irritojë njerëzit. Sot Kosova është duke u qeverisur nga partia shtet. Asnjëherë vendi nuk është drejtuar nga një parti e vetme. Tendencat për të kapur gjithçka, shpejt do t'i tregojnë rreziqet ku do të jetë demokracia e Kosovës. Shenjat janë dhënë në këto dy-tri ditët e fundit. Asnjëherë nuk ka ndodhur që partia në pushtet të ndryshojë ligjin zgjedhor krye në vete. Ligj zgjedhor ndryshohet me konsensus dhe

me kryesimin e opozitës sepse kjo nuk është çështje numri e votash. Njerëzit autoritarë punën e parë që e bëjnë janë ndërhyrja te ligji zgjedhor për t'ia përshtatur vetes rregullat e lojës dhe kjo ka ndodhur në sistemet ku ka mendësi autokrate", ka thënë Limaj në Kuvendin Zgjedhor të Degës së Nismës në Malishevë. I pari i Nismës ka thënë se Kosova ka nevojë për këtë frymë politike me adresë racionale e më eëmbajtje të

jetë e bashkuar në betejat që na vijnë, duke shtuar se nuk duhet ndikuar disponimet e çastit. Lideri i Nismës është shprehur i sigurt se nga ky kuvend do të dalë ekipi fituesi i zgjedhjeve lokale që do të mbahen në tetor të këtij viti. "Ky kuvend mbahet në një moment të veçantë për vendin dhe partinë. Jemi të vetëdijshëm për angazhimin që duhet ta kemi dhe që duhet dalë nga ky kuvend. Shpreh nderimin tim për gjithë ata burra e gra të cilët në mes dy

kuvendeve kanë ndërruar jetë. Organeve që dalin nga ky Kuvend iu dëshiroj shumë suksese dhe ne duhet ta ndërtojmë ekipin fitues të zgjedhjeve lokale. Unë ju ftoj që së bashku t'i vazhdojmë angazhimet e përbashkëta për t'i kaluar me sukses sfidat e radhës", ka shtuar Limaj. Pas fjalës së Limajt, Kuvendi ka vazhduar punimet për zgjedhjen e strukturave të reja ku janë zgjedhur organet e reja të degës.

Emërohen zëvendësministriat në tetë ministri



PRISHTINË, 4 PRILL (ER) - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, në javën e dytë të marrjes së detyrës, ka emëruar tetë zëvendësministra, të cilët i ka uruar për pozitën e re dhe iu ka dëshiruar suksese për plotësimin e detyrave dhe përgjegjësi të tyre.

Zëvendësministriat e emëruar janë: Getoar Mjeku, zëvendësministër i Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë Nita Shala, zëvendësministre e Drejtësisë Gazmend Salijeвиq, zëvendësministër

për Komunitete dhe Kthim Adnan Redxheplari, zëvendësministër i Mbrojtjes Sejnur Veshall, zëvendësministër i Kulturës, Rinisë dhe Sportit Almir Veliji, zëvendësministër i Zhvillimit Rajonal

Avod Djesheviq, zëvendësministër i Administrimit të Pushtetit Lokal Qazim Rrahmani, zëvendësministër i Financave, Punës dhe Transfereve Deri më tani me vendim të kryeministrit të Republikës së Kosovës janë emëruar 11 zëvendësministra.

Në Mitrovicë shënohet 40-vjetori i demonstratave të vitit 1981

MITROVICË, 4 PRILL (ER) - Në Qendrën e Kulturës "Rexhep Mitrovica", buzë lumit Ibër, është shënuar 40-vjetori i demonstratave të vitit 1981. Të pranishëm në këtë akademi përkujtimore ishin nënkryetari i komunës, Faruk Mujka, drejtorë komunalë, Bajrush Xhemajli, ish-deputet e kryetar i Ferizajt, njëherësh pjesëmarrës i demonstratave të vitit 1981 në Mitrovicë si dhe pjesëmarrës të tjerë nga Shoqata e të Burgosurve Politikë.

Në fjalën e tij nënkryetari Mujka ka thënë se demonstratat e vitit 1981 e kthyen Kosovën me fytyrë nga vetëvendosja popullore e nga Shqipëria, i dhanë vull dhe energji lëvizjeve të pandërprera dhe organizimeve ilegale e legale që punonin për Republikën e

Kosovës, për liri e barazi kombëtare, për drejtësi e progres shoqëror. "Kështu ato u bënë hapi i parë në rrugën e gjatë e të dhimbshme, por plot krenari, që solli rrëzimin e ish-Jugosllavisë dhe çlirimin e Kosovës në vitin 1999. Në këto demonstrata populli i Kosovës u ngrit kundër shtypjes, shfrytëzimit, padrejtësisë dhe represionit të përjetuar nga pushtuesi jugosllav", ka thënë Mujka.

Ndërsa Bajrush Xhemajli, një nga pjesëmarrësit e këtyre demonstratave në qytetin e Mitrovicës, ka thënë se vrasjet, burgosjet, torturat ndaj shqiptarëve ishin jo vetëm për t'i shuar demonstratat, por edhe hakmarrje për guximin e treguar të demonstruesit, në mënyrë që t'i frikësojnë ata. Ai ka



potencuar rëndësinë e demonstratave të atëhershme si të jashtëzakonshme për shkak se pushtuesit iu bë me dije se shqiptarët janë në gjendje të

vdesin për lirinë e tyre. Në këtë akademi folën edhe pjesëmarrës të tjerë për periudhën e atëhershme dhe të lavdishme të demonstratave të vitit '81 si

fillimi i fundit të Jugosllavisë dhe të kohës kur u shtuan veprimet atdhetare me çka kulmoi edhe UÇK-ja që i priu popullit e që ne tani gëzojmë lirinë.



Zbulohet pllaka përkujtimore e shtabit lokal e UÇK-së në Lumbardhë të Deçanit

DEÇAN, 4 PRILL (ER) - Ish-kryeministri dhe lideri i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, së bashku me kryetarin e Komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, kanë bërë zbulimin e pllakës

përkujtimore të shtabit lokal të UÇK-së në fshatin Lumbardhë të Komunës së Deçanit. Haradinaj ka thënë se Kosova duhet t'i ruajë vlerat e luftës së UÇK-së. "Vlerat e UÇK-së ishin dhe do të mbesin përgjith-

monë më sublimet për vendin tonë", ka thënë Haradinaj. Ndërkaq kryetari i Deçanit, Bashkim Ramosaj, ka theksuar se përgjithmonë do të jenë mirënjohës Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Inaugurohet Stacioni i Transferimit të Mbeturinave në Gjakovë

GJAKOVË, 4 PRILL (ER) - Në Gjakovë është inauguruar Stacioni i Transferimit të Mbeturinave, një projekt ky që përmes përpunimit të mbeturinave do të ndikojë dukshëm në përmirësimin e situatës në lagjen "Ali Ibra". Në ceremoninë e inaugurimit ka marrë pjesë edhe kryetari i Komunës së Gjakovës Ardian Gjini dhe ministri i Administrimit Lokal, Elbert Krasniqi, të cilët e kanë vlerësuar lart këtë projekt, duke shtuar se si institucionet lokale, po ashtu edhe ato qen-

drore, do të angazhohen që me përkrahje të vazhdueshme ta mbështesin këtë qendër dhe të ndikojnë në përmirësimin e situatës me mbeturina në Komunën e Gjakovës. Inaugurimi i Stacionit Transfer të Mbeturinave është realizuar në kuadër të projektit "Së bashku kundër ndotjes", është financuar përmes Programit të Bashkëpunimit Ndërkufitar Mali i Zi - Kosovë në kuadër të projektit të Asistencës për Para-Anëtarësim, ndërsa është implementuar nga organizata "Let's Do It Peja".



Gjilani nënshkruan memorandum mirëkuptimi me UBT-në për digjitalizimin e lejeve të ndërtimit



GJILAN, 4 PRILL (ER) - Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka nënshkruar memorandum mirëkuptimi me Universitetin e Biznesit dhe Teknologjisë (UBT), përkatësisht rektorin prof. dr. Edmond Hajrizi. Qëllimi i këtij memorandum është digjitalizimi i lejeve të ndërtimit për Drejtorinë e Urbanizmit.

Kryetari Haziri e ka falënderuar rektorin Hajrizi për bashkëpunimin e ofruar në të mirë të qytetarëve të Gjilanit. Në fazën e dytë pritet të bëhet edhe digjitalizimi i bibliotekës së qytetit "Fan S. Noli dhe bibliotekave të shkollave të mesme, sikurse edhe bashkëpunimi mes Fakultetit të Bujqësisë dhe institutit të

bujqësisë në UBT me shkollën e mesme të agrobiznesit "Arbëria", për zhvillimin e edukimit për programin e bujqësisë. Në fund, rektori i UBT, Edmond Hajrizi, e ka falënderuar kryetarin Haziri për gatishmërinë e bashkëpunimit në çdo kohë, për të mirën e përgjithshme.

Shkuarja e vendit në zgjedhje, e rrezikshme për ekonominë

PRISHTINË, 4 PRILL - Dështimi i zgjedhjes së presidentit do ta detyronte vendin që të shkonte në zgjedhje të parakohshme parlamentare.

Nga këndvështrimi ekonomik, një palë zgjedhje të tjera pas atyre të 14 shkurtit dhe para atyre lokaleve që pritet të mbahen në vjeshtë po konsiderohet e rrezikshme dhe shkatërruese për Kosovën.

Drejtori i Odës Ekonomike Amerikane, Arian Zeka, ka thënë se mbajtja e zgjedhjeve ka ndikim negativ aq më tepër në kohë pandemie, ku dëmet më të

mëdha, sipas Zekës, do të jenë sa i përket rritjes ekonomike, tërheqjes së investimeve të huaja dhe për të hyrat buxhetore. “Në këtë aspekt mbajtja e shpeshtë e zgjedhjeve, shikuar edhe në aspektin historik, në vendin tonë gjithmonë ka ndikuar edhe në normën e përgjithshme të rritjes ekonomike, edhe te tërheqja e investimeve të huaja direkte, por edhe te të hyrat e mbledhura për buxhetin e vendit. Në një situatë hipotetike kur ne do të kishim zgjedhje më të shpeshta brenda një intervali të shkurtër kohor, besoj se ndikimi në ekonomi do

të ishte shkatërrues, aq më tepër nëse kombinohet sërish me ndikimin që ka pandemia Covid-19, e që ka pasur gjatë vitit 2020”, ka thënë Zeka për “KosovaPress”. Ai ka theksuar se stabiliteti politik është faktor i rëndësishëm në vendimmarrjen afariste prandaj, sipas Zekës, mbajtja e shpeshtë e zgjedhjeve bën që vendimet afariste të frenohen. “Vetvetiu një pasiguri e tillë ose mungesa e stabilitetit politik apo edhe mbajtja e shpeshtë e zgjedhjeve bën që vendimet afariste të frenohen dhe investitorët, të brendshëm

apo të jashtëm, të presin për momentin që ata e konsiderojnë të volitshëm për t’i zbatuar pastaj planet e tyre për zgjerim të investimeve apo për investime të reja”, ka thënë Zeka.

Eksperti i ekonomisë, Lekë Musa, ka pohuar se ndërrimi i shpeshtë i qeverive ndikon negativisht në tërheqjen e investitorëve të huaj si dhe në realizimin e investimeve strategjike. “Për shkak të ndërrimit dhe të një jostabiliteti të vazhdueshëm politik dhe ndërrimit të shpeshta të qeverive, nuk kanë arritur

asnjëra prej tyre që të realizojnë ndonjë projekt të madh strategjik nëpërmjet këtij legjislacioni apo edhe vetë implementimit të programeve ekonomike. Kështu që, edhe në aspektin e tërheqjes së investitorëve të huaj ata në rend të parë e shohin një vend shumë jostabil në aspektin politik dhe ndërrimet e shpeshta të qeverive japin na nxitin të besojmë se ky vend nuk është serioz dhe nuk mund të ketë një konsistencë të implementimit dhe realizimit të ideve të ndryshme ekonomike”, ka thënë Musa.



AVUK-u realizoi 80 inspektime në Prizren, shqiptoi gjoba dhe mbylli disa lokale



PRIZREN, 4 PRILL (ER) - Të shtunën në mbrëmje Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë e Kosovës (AUVK) përmes Inspektoratit Sanitar, Zyra Regionale në Prizren, ka

realizuar 80 inspektime për mbikëqyrje të masave Covid-19 dhe ka ndëshkuar katër lokale me gjoba, ndërkaq dy lokale janë mbyllur. Lajmin e ka bërë me dije për “Epokën e

re” Lamir Thaçi, zëdhënës i Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë së Kosovës (AUVK). Ai, po ashtu, ka treguar se janë zbratur nga klientët katër lokale. “Moskrijimi i

kushteve për ruajtje të distancës dhe mbajtja e organizimeve dhe ahengjeve ishin arsyet e ndëshkimeve. Të gjitha inspektimet realizohen bashkë me Policinë e Kosovës.

Punojmë bashkë të koordinuar për t’i penguar grumbullimet e njerëzve në hapësira të mbyllura. Si shkelës të masave janë gjobitur edhe dhjetë persona fizikë”, ka thënë Thaçi.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Prishtina merr tri pikë në Suharekë, 'Nikli' deklason Llapin

Prishtina dhe Feronikeli kanë shijuar fitore të dielën, kurse të shtunën fitoreve iu gëzuan edhe Drita dhe Drenica. Sot (e hënë) mbyllet java e 27 me ndeshjen në mes të Gjilanit dhe Besës



EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 4 PRILL - FC Prishtina dhe Feronikeli kanë shijuar fitore të dielën kundër Ballkanit, përkatësisht Llapit. Në derbin e zhvilluar në Suharekë, skuadra nga kryeqyteti e ka fituar me rezultat minimal 0-1. "U pa që goli ndikoi për keq, por do të thosha se deri në ato minuta nuk kemi bërë lojë të mirë. Nga ana psikologjike goli ndikoi për keq dhe në asnjë moment nuk arritëm të bëjmë atë lojën që kjo skuadër bën, Ballkani do të jetë deri në fund në luftë me këto dy ekipe, është një garë interesante, ka shumë pikë në lojë, ka edhe 9 ndeshje. Ne do të bëjmë mirë dhe do ta marrim maksimumin e mundshëm", ka thënë pas ndeshjes Bledi Shkëmbi, trajner i Ballkanit.

Në minutën e 35-të Armend Thaqi në tentimin për ta larguar topin shënoi autogol për 0-1. Vendasit u munduan të rikthehen në lojë, por pa sukses. Prishtina me tri pikët e reja është rikthyer seriozisht në garë për titull dhe tash ka një pikë më pak se Ballkani në vendin e dytë dhe katër më pak se Drita që ka marrë pozitën e parë. Kjo humbje mund t'i kushtojë skuadrës së Ballkanit, pasi lëshoi pikë si vendëse ndaj një rivali për titull. "Ishim përgatitur për një derbi të vërtetë, për një luftë sportive në mesfushë dhe e arritëm qëllimin. U thashë futbollistëve se duhet të luftojmë të shënojmë një gol për barazim apo fitore dhe doli që ai

autogol të jetë vendimtar për fitoren. Ajo ndeshje ndaj Gjilanit tregoi se ishte vetëm një ditë e keqe dhe nuk ishte fati në anën tonë", ka thënë pas ndeshjes trajneri i Prishtinës, Zekerija Ramadani.

Ndërsa Feronikeli e ka harruar humbjen befasuese nga Besa dhe të dielën arriti fitore me rezultat bindës ndaj Llapit (4-0). Klubi nga Drenasi ishte më efikas në përbalje me skuadrën e drejtuar nga Tahir Batatina dhe si rezultat i kësaj realizoi katër gola për ta marrë maksimumin e pikëve. Mysafirët janë mbajtur vetëm deri në fund të pjesës së parë, kur Marko Milickoviq shënoi golin e parë për "Niklin", derisa në pjesën e dytë, Marko Milickoviq shfrytëzoi një asistim të Yll Hoxhës dhe realizoi për 2-0. Dy gola të tjerë për skuadrën e "Niklit" i realizoi sulmuesi Marko Simonovski. Pas kësaj ndeshje, Feronikeli ngritët në pozitën e pestë me 34 pikë të grumbulluara, kurse Llapi ka një pikë më pak dhe renditet në vendin e gjashtë.

Ndërsa të shtunën kampionia në fuqi, Drita, ka shënuar fitore në udhëtim, duke e mposhtur Arbërinë me rezultat 3-1, në ndeshjen e zhvilluar në stadiumin "Zahir Pajaziti" në Podujevë. Të parët shënuan futbollistët e trajnerit Arbnor Morina në minutën e 23-të nëpërmjet Dion Zabërgjës. Megjithatë, mysafirët reagan shpejt dhe arritën që brenda pjesës së parë ta përmbysin rezultatit me golat e Festim Alidemës në minutën e 27 dhe Priesleyt në

minutën e 33-të. Ndërkohë, rezultatit përfundimtar e vulosi Betim Haxhimusa në minutën e 63-të. Pas kësaj fitoreje, Drita është në pozitën e parë me 58 pikë. Në ndeshjen tjetër, Drenica fitoi duelin me Trepçën '89, me shifrat 2-0. Golat për kuqezinjët e Skenderajt i shënuan Baton Zabërgja dhe Donald Rapo. Pas kësaj fitoreje Drenica mban vendin e 8-të me 30 pikë, kurse Trepça '89 është në pozitën e shtatë, me dy pikë më shumë. Sot (e hënë) zhvillohet ndeshja e fundit për javën e 27-të, ku Gjilani e pret skuadrën e Besës së Pejës.

SUPERLIGA - Java 27

Ballkani - Prishtina	0-1
Feronikeli - Llapi	4-0
Drenica - Trepça '89	2-0
Arbëria - Drita	1-3

Të hënën takohen:
15:00 Gjilani - Besa

Tabela

1. Drita	27	58 pikë
2. Ballkani	27	55
3. Prishtina	27	54
4. Gjilani	26	37
5. Feronikeli	27	34
6. Llapi	27	33
7. Trepça '89	27	32
8. Drenica	27	30
9. Arbëria	27	27
10. Besa	26	10

Në xhiron e radhës takohen: Gjilani-Feronikeli, Ballkani-Besa, Llapi-Drita, Drenica-Prishtina, Arbëria-Trepça '89.

SHKURT

'Dardanët' arrijnë në Holandë

Përfaqësuesja e Kosovës në futsall ka arritur në Zeist, ku më 5 dhe 6 prill do t'i zhvillojë dy ndeshje miqësore kundër Kombëtares së Holandës. "Dardanët" e futsallit kanë zhvilluar dy ditë stërvitje në Prishtinë, derisa të dielën e kanë mbajtur edhe një stërvitje në Zeist për t'u përgatitur sa më mirë për duelin me "Tulipanët". Këto miqësore do të jenë dy ndeshjet e para për përzgjedhësin e ri Arben Simitçiu.

Besa Famgas nuk njeh humbje në Superligë

Besa Famgas e ka shënuar fitoren e 26-të rresht në këtë edicion të Superligës së Kosovës në hendboll. Në kuadër të Superligës A, skuadra pejane fitoi në "Karagaçi" me rezultat bindës 41:22 ndaj Trepçës nga Mitrovica. Nikola Prce realizoi 8 gola për Besën, kurse Arbios Mushkolaj e Víctor Alonso i realizuan nga 6. Fidan Cimili e Kapllan Terziqi i shënuan nga 5 gola për Trepçën. Besa udhëheq në tabelë me 52 pikë. Trepça është e treta me 28 pikë. Fitore shënoi edhe Kastrioti i Ferizajt. Kastrioti në Drenas e mposhti Drenicën me rezultat 33:27. Për Kastriotin ishte fitorja e 13-të. Me 26 pikë skuadra ferizajase renditet e katërta. Drenica është e gjashta me 16 pikë. Festim Mustafa shënoi 14 gola për Kastriotin, kurse Endrit Hamza shënoi 10 gola për Drenicën.

Fenerbahçe e dëshiron Hysajn

Elseid Hysaj luan sezonin e fundit me skuadrën e Napolit, teksa pas përfundimit të kampionatit ka vendosur të largohet për ta vazhduar karrierën diku tjetër. Mbrojtësi shkodran shpesh është lidhur me një kalim të mundshëm te skuadra e Milanit, me të cilën janë në kërkim të një mbrojtësi të djathtë dhe Hysaj shihet si alternativa e duhur. Në Turqi raportojnë se në gjurmët e Hysajt është vënë edhe Fenerbahçe.

Përfundojnë garat e rregullta në EBC Ligën e Femrave

Dita e shtunë ishte e fundit për garat e rregullta në EBC Ligën e Femrave. Në ndeshjen e fundit për garat e rregullta, Prishtina ka shënuar fitore ndaj Kastriotit me shifrat 100:43. Basketbollistja më e dalluar ishte Djellza Dekaj me katërshifror të dyfishtë me 34 pikë, 10 kërcime, 10 asistime dhe 10 topa të vjedhur.

Në takimet e tjera të xhiros së fundit Bashkimi ka mundur Vëllaznimin 85:70, kurse Penza mundi Trepçën 45:98. Renditja përfundimtare është: Bashkimi me 38 pikë, Prishtina dhe Penza me 33, Vëllaznimi 32, Kastrioti 23 dhe Trepça 21. Në gjysmëfinale të "Play-off"-it do të ndeshen Bashkimi me Vëllaznimin dhe Prishtina me Penzën. Skuadra që shënon dy fitore kualifikohet në finale.

Ylli fitoi dramën ndaj Pejës

SUHAREKË, 4 PRILL - Golden Eagle Ylli ka shënuar fitore ndaj Pejës me rezultat 78:74 (19:19, 17:18, 18:20, 24:17) në kuadër të javës së 27-të në FIVE STAR Superligën e Kosovës në basketboll. Çereku i parë ishte tërësisht i barabartë dhe këtë e dëshmon

edhe rezultati 19:19. Lojë e baraspeshuar u zhvillua edhe në periudhën e dytë, 17:18, ku skuadrat shkuan në pushim me shifrat 36:37. Pejanët e nisën më mirë pjesën e dytë, duke pasur epërsi deri në tetë pikë, 39:47, dhe kishin epërsi konstante, derisa rezultati në

semafor pas 30 minutash ishte 54:57. 1:44 minuta nga fundi, verdhezinjtë ishin duke fituar 69:74, por nga ky moment vendësit hyn në një seri prej 9:0, duke triumfuar në fund 78:74. Lg Gill shënoi 16 pikë për vendësit, 15 shtoi Valon Bunjaku dhe nga 13 Erjon

Kastrati dhe Gëzim Morina, kurse te Peja u dalluan Brandon Walters me 17 pikë e 15 kërcime dhe Laron Dendy me 18 pikë e 12 kërcime, ndërsa Trepça ka shënuar fitore ndaj Rahovecit me rezultat 71:60 (19:10, 17:23, 12:15, 23:12).



Historia e klubeve shqiptare që luajnë në Ligën Unike

PRISHTINË, 4 PRILL - Pritjes i erdhi fundi dhe Liga Unike do të fillojë më 6 prill. Nga Federata Shqiptare e Basketbollit janë nominuar Teuta, Goga Basket, Tirana dhe Vllaznia. Teuta e Durrësit është formuar në vitin 1925, duke qenë një skuadër me shumë traditë në basketbollin e Shqipërisë.

Skuadra nga Durrësi ka fituar dy herë titullin, më 1947 dhe 1955, si dhe tri herë Kupën e Shqipërisë. Nga basketbollistët në vitet e fundit dallohet Endrit Hysenagolli, ndërsa kapiten është Kristi Gorea. Ndërsa Goga Basket është, gjithashtu, skuadër nga Durrësi, që është formuar më 2015. Skuadra durrsake më 2019 fitoi titullin, ndërsa edicionin e kaluar kampionati ishte i ndërprerë për shkak të pandemisë me Covid-19. Goga Basket, gjithashtu, ka fituar edhe një herë Kupën më 2020. Ndërkohë Tirana është një nga skuadrat më të trofeshme shqiptare. Skuadra bardhekaltër ka fituar 20 herë titullin, 18 herë



Kupën dhe 8 herë Superkupën apo 46 trofe në përgjithësi dhe vetëm skuadra e Partizanit ka më shumë trofe 48. Klubi është formuar më 1946. Basketbollisti i dalluar është Gerti Shima, që ka bërë karrierë edhe në Kosovë.

Ndërkohe Vllaznia e Shkodrës është formuar më 1919 apo klubi

më i vjetër në Shqipëri. Skuadra nga Shkodra ka fituar nëntë herë titullin, 12 herë Kupën dhe një herë Superkupën. Vllaznia ka luajtur në Ligën Ballkanike ndaj skuadrave nga Kosova, andaj pjesëmarrja në Final 8 të Ligës Unike pritet të jetë shumë interesante.

Utah nuk ndalet, Spurs pësoi humbjen e dytë në shtesë

SALT LAKE CITY, 4 PRILL - Utah Jazz ka regjistruar fitoren e tetë radhazi dhe të 38-n sezonale pasi ka mposhtur me rezultatin e thellë 137-91 Orlando Magic dhe ka blinduar pozitën në krye të renditjes në Konferencën e Perëndimit. Sfidat në "St. Lake City" nuk pati aspak histori, pasi vendësit dominuan ndjeshëm në gjysmën e parë dhe arritën të sigurojnë një epërsi prej 38 pikësh, ndërsa Orlando Magic u zgjua vetëm në fraksionin e tretë, por pa arritur ta hapë ndeshjen. Një nga sfidat më interesante të mbremjes ishte ajo mes San Antonio Spursit dhe Indiana Pacersit, teksa vendasit pësuan humbjen e dytë radhazi pas luajtjes së kohës shtesë. Koha e rregullt e ndeshjes në San Antonio u mbyll me rezultatin e barabartë 126-126,



ndërsa në shtesën pesëminutëshe ishin miqtë nga Indiana që bënë diferencën dhe arritën ta sigurojnë fitoren me shifrat 133-139. Vijon të bëjë mirë edhe Portland Trail Blazersi, që la menjëherë pas krahëve humbjen ndaj Milwaukee Bucksit dhe fitoi me rezultatin e thellë 133-85 ndaj Oklahoma City Thunderit. Në Konferencën e Lindjes vijon të dominojë Philadelphia 76ers, që triumfoi me

shifrat 122-113 në "Wells Fargo Center" përballë Minnesota Timberwolvesit. Sfidat nisi më mirë për miqtë, falë edhe një forme mjaft të mirë të Karl-Anthony Towns, i cili u shpall edhe MVP i ndeshjes me 39 pikë të shënuara, 14 topa të rikuperuar dhe 5 asistime. Megjithatë, Philadelphia mori kontrollin e lojës dhe arriti ta fitojë thellë fraksionin e dytë dhe të tretë, duke mbyllur llogaritë e ndeshjes dhe duke i lejuar vetes një tolerim në pjesën e fundit, raporton "Supersport". Në sfidat e tjera, Miami Heat fitoi me rezultatin 115-101 ndaj Cleveland Cavaliers, Washington Wizardsi u mposht me shifrat 87-109 ndaj Dallas Mavericksit dhe New York Knicksit triumfoi me shifrat 81-125 në transfertën ndaj Detroit Pistonsit.

SHKURT

Neymari mund të rikthehet në Barcelonë

Sulmuesi brazilian Neymar duket se mund të bëjë një rikthim në Barcelonë. Mediume katalanase shkruajnë se ai ka ndërprerë bisedimet me Paris Saint-Germainin për rinovim të kontratës, pasi Lionel Messi mund të qëndrojë në klubin spanjoll. Ai duket se ka dëshirën të luajë sërish me argentinasi, ndërsa Andre Cury, ish-agent i Barcelonës, ka thënë se Neymari mund të luajë krahas Messit vetëm në Barcelonë.

'TuttoSport': Për këtë arsyeja Ronaldo mund të largohet nga Juve

Dëshira e Cristiano Ronaldos është respektimi i kontratës së tij me Juventusin, por me një vend në Ligën e Kampionëve të munguar për sezonin e ardhshëm e ardhmja e yllit portugez mund të ndryshojë krejtësisht. Sipas asaj që raporton e përditshmja sportive italiane "TuttoSport", askush nuk dëshiron ta mendojë këtë fakt në shtëpinë e Juventusit, sidomos Ronaldo i cili nuk do të ishte i lumtur të mos aktivizohej në kompeticionin e Ligës së Kampionëve.

Pique në dyshim për 'El Clasico'

Qendërmbrojtësi i Barcelonës, Gerard Pique, mund të mungojë në ndeshjen ndaj Real Madridit në La Liga. Shërimi i Piques nuk po shkon aq shpejt sa ishte planifikuar në ditët e fundit dhe kjo ka alarmuar klubin katalanas. Ai ende nuk ka qenë në gjendje të përfundojë një sesion të plotë me grupin. Ndeshja "El Clasico" zhvillohet të shtunën dhe mund të jetë domethënëse për titullin kampion. Prej ndeshjes gjysmëfinale në Copa Del Rey ndaj Sevillas, Gerard Pique nuk është paraqitur më për Barcelonën.

Arteta: Liverpooli e meritoi fitoren

Trajneri i Arsenalit, Mikel Arteta, ka përgëzuar Liverpoolin për fitoren dhe ka marrë përgjegjësinë totale për humbjen. Liverpooli fitoi me rezultat të thellë ndaj Arsenalit në udhëtim në Londër për të marrë frymë lirshëm dhe për t'iu rikthyer fitoreve pas një serie negative. "Jam i zhgënjyer, ata merituan të fitojnë në çdo aspekt dhe unë e pranoj këtë gjë. Ata fituan çdo duel, çdo top dhe ishin të guximshëm kur kishin topin, ndërsa ne jo, ky është faji im", ka thënë Arteta. "Është faji im sepse vendosa këtë skuadër në fushë. Është përgjegjësia ime. Urime Liverpoolit sepse ka zhvilluar një ndeshje fantastike! Ne, po ashtu, pamë dallimin mes skuadrave. Ne humbëm topa shumë. Nuk mund t'i kompletojmë as tre pasime dhe në këso lloj ndeshje ndëshkohesh", ka shtuar Arteta.

8 000 tifozë në finalen e 'Carabao Cup' në Angli

Një nga vendet që ka avancuar më shumë me procesin e vaksinimit është Anglia dhe qeveria e vendit atje ka dhënë miratimin zyrtar që të hapen dyert e stadiumit "Wembley" më 25 prill, me rastin

e finales së Carabao Cup, mes Manchester Cityt dhe Tottenhamit. Lajmin e ka dhënë vetë klubi londinez nëpërmjet një komunikate zyrtare, ku sqaron se është miratuar tashmë prania e 8

000 tifozëve në shkallët e "Wembley"-t, ose e 10 % të kapacitetit të plotë të stadiumit. Në deklaratë thuhet se ende nuk është vendosur si do të përzgjidhen tifozët që do të

lejohej ta ndjekin ndeshjen nga shkallët e stadiumit, pasi qeveria britanike ka propozuar që të futen vetëm ata që kanë arritur të vaksinohen. Ky do të jetë edhe një test paraprak para se të lejohet

prania e tifozëve edhe në stadione të tjera, si dhe të rritet përqindja të paktën deri në masën 30 %, që është edhe synimi kryesor i UEFA-s për ndeshjet e Kampionatit Evropian.



Daut Dauti është historian, gazetar publicist dhe prozator. Ka kryer studimet në Fakultetin Juridik në Prishtinë, ka magjistruar në West London University në degën e Studimeve Evropiane, kurse ka doktoruar në University of Leeds në shkollën e njohur të historisë të këtij universiteti.

Në fund të viteve '80 ka filluar të merret me gazetari. Shkrimet e para i ka botuar në gazetën e studentëve *Bota e re*, pastaj në revistën *Zëri*. Nga viti 1994 deri më 1999 ka qenë korrespondent i *Zërit* nga Londra. Në vitin 1999 ka filluar të punojë në redaksinë IWPR (Institute for War and Peace Reporting) dhe në këtë vit ka themeluar zyrën e këtij instituti në Prishtinë.

Nga viti 1999 deri më 2002 ka qenë sekretar dhe ndër themeluesit e Shoqatës së Gazetarëve të Kosovës dhe ka shërbyer anëtar i Këshillit Qendror të Zgjedhjeve. Gjatë vitit 2002 në institutin amerikan *Kettering Foundation* ka hulumtuar temën e mediave të pavarura dhe që nga ky vit është anëtar i ekipit hulumtues-studues i këtij instituti. Dauti ka punuar në disa organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare. Ka qenë dhe zëdhënës i Qeverisë së Kosovës në vitin 2005.

Daut Dauti është autor i disa librave dhe punimeve shkencore. Punimet e tij me temë nga fusha e historisë, e gazetarisë dhe e letërsisë janë botuar në mediat shqipe dhe në revista të njohura ndërkombëtare.

Një palë këpucë në Berlin është novela e tij e parë.

4⁹⁹ €



Daut Dauti

Daut Dauti

Daut Dauti NJË PALË KËPUCË NË BERLIN

novelë



Prallëherë ndodh që lexuesi, pasi ta ketë lexuar librin, të marrë informacion, të gjejë thellësi mendimi, shqyrtim profesional dhe njerëzor të një krijimtari filmike sikurse i merr dhe i gjen në librin e Agron Shalës. Njëjtë si Kiesłowski që i linte të hapura veprat e tij, Shala nuk pretendon të mbyllë asgjë por, duke shqyrtuar në dimensionin artistik, politik, fetar e njerëzor, hap mundësi të reja interpretimi për dekalogun e ditëve tona.

Zymer Kelmendi

Ky libër është interpretim për dramën serike "Dekalogu" të regjisorit Krzysztof Kiesłowski, i ndërthurur me një egzgjenezë të lirë autoriale të veprave të kulturave të lashta, ku nuk mungojnë as analiza psikologjike e etike që lidhen me karakteret dhe veprimet e protagonistëve të dramës, por edhe me jetën dhe besimin e shqiptarëve sot. Një libër i shkruar me një gjuhë të rrjedhshme, që me çdo fjali të shtyn ta lexosh më tutje. Konsideroj se ky libër përbën një kontribut të pasur shkencor në opusin e kritikës së veprave artistike.

Kristë Shtufi

Një libër që zbërthen relacionet e njeriut me fenë dhe Zotin, që bazohet në një vepër filmike, por që përçohet te ne nëpërmjet urdhrave biblike. Autori në mënyrë të mprehtë dhe me delikatesë e ndërlidh temën e besimit në Zot, ekzistencën e religjioneve të shqiptarët, duke bërë ndarjen mes fesë dhe identitetit kombëtar. Shkurt, ky është një libër i shkruar me kujdes, me një gjuhë të pastër dhe krejtësisht intelektuale, e që do të duhej të lexohej nga secili.

Fadil Sahiti

... përmes mikrobotës së Kiesłowski, "Dekalogu" i Agron Shalës na dëshmon se mund të ringjallet metamorfoza progresive e mendjes tonë...

Orhan Kerkezi

Kur shikohet "Dekalogu" i Kiesłowski dhe kur lexohet libri i Shalës, kuptohet thënia se 'thjeshtësia është madhështi'.

Daut Dauti

ÇMIMI: 5.99 €



AGRON SHALA

DEKALOGU

nga Moisiu deri te Kiesłowski

AGRON SHALA | DEKALOGU | NGA MOISIU DERI TE KIEŚŁOWSKI

Duke u bazuar në Nenin 57 të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025, operatori i kompanisë "Gentipharm" Sh.p.k. Fabrikë për prodhimin e barnave farmaceutike, Korroticë e Epërme, Glllogoc, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Aplikacionin për dhënie e Lejes Mjedisore të Integruar

Njoftohet publiku i interesuar se më datë: 26.04.2021, në ora 10:00, në hapësirat e Gentipharm, Komuna e Glllogocit, do të organizohet debat publik nga operatori i kompanisë "Gentipharm" Sh.p.k. fabrikë për prodhimin e barnave farmaceutike, Korroticë e Epërme, Glllogoc, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Debati publik do të organizohet për aplikacionin për dhënie e Lejes Mjedisore të Integruar.

Pjesëmarrja e juaj në ndihmon në implementimin e projektit.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Sedat Morina shpall te pavlefshme diplomën shmt "11 Marsi " Prizren

► Halit Kolgeci shpall te pavlefshme diplomën shmt "11 Marsi " Prizren

Fisnik Arifaj shpall te pavlefshme deftesat e kl I-IX shfmu "Heronjet e Lumes" Vermice

► Shkelqim Memaj shpall te pavlefshme diplomën shmt "11 Marsi " Prizren

► Haki Fejzi shpall te pavlefshme diplomën shmt "11 Marsi " Prizren

► Kasem Dervishi shpall te pavlefshme diplomën shmt "11 Marsi " Prizren

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.23-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Feja", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Feja" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalim më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afat të gjatë dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

► Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

► Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.

► Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo, ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet. Për info: 045/699-221.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

